

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 218, datë 20.12.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘HEC Arsti’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Arsti’” botuar në Fletoren Zyrtare nr.191, datë 22.1.2020,

Bëhet korrigjimi si më poshtë:

Pika 1 e vendimit nuk ka asnjë ndryshim dhe ka këtë përmbajtje: *Të licencojë shoqërinë “HEC Arsti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Arsti”, me fuqi të instaluar 3130 kW, për një afat 30-vjeçar.*

Pika 2 e vendimit ishte: Shoqëria “HEC Arsti” sh.p.k. të depozitojë në ERE lejen e Ujit të rinovuar në përfundim të afatit të saj, më datë 13.8.2023.

Pika 2 e vendimit bëhet: *Pika 2 e këtij vendimi shfuqizohet dhe pika 3 bëhet pika dy dhe më konkretisht me këtë përmbajtje: Ky vendim është objekt rishikimi nëse shoqëria “HEC Arsti” sh.p.k., depoziton në ERE, kontratën e ndryshuar të koncesionit, me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për reflektimin e parametrave hidroenergjetikë dhe ndryshimit të programit të punimeve dhe fuqisë së instaluar, sipas projektit të zbatimit.*

Pika 3 e vendimit ishte: Pika e 3 e vendimit kishte përmbajtjen e pikës 2 së mësipërme dhe me konkretisht: Ky vendim është objekt rishikimi nëse shoqëria “HEC Arsti” sh.p.k., depoziton në ERE, kontratën e ndryshuar të koncesionit, me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për reflektimin e parametrave hidroenergjetikë dhe ndryshimit të programit të punimeve dhe fuqisë së instaluar, sipas projektit të zbatimit.

Pika 3 e vendimit bëhet: *Pika e 3 ndryshon dhe ka përmbajtjen e pikës 4 së mëparshme dhe më konkretisht: Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.*

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 383, datë 28.12.2023, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 218, datë 20.12.2019 ‘Mbi licencimin e shoqërisë HEC ‘Arsti’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Arsti’ me kapacitet të instaluar 3130 kW” botuar në Fletoren Zyrtare nr.53, datë 28.3.2024,

Bëhet korrigjimi si më poshtë:

Pika 1 e vendimit nuk ka asnjë ndryshim dhe ka këtë përmbajtje: *Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 218, datë 20.12.2019, shfuqizohet.*

Pika 2 e vendimit ishte: Pika 3 e vendimit nr. 218, datë 20.12.2029, bëhet pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 218/2019.

Pika 2 e vendimit bëhet: **Ndryshimi i vitit në fjali dhe ka këtë përmbajtje:** Pika 3 e vendimit nr. 218, datë 20.12.2019, bëhet pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 218/2019.

Pika 3 e vendimit nuk ka asnjë ndryshim dhe ka këtë përmbajtje: Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë HEC “Arsti” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.